



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:012845
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05404132

2022:012846

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Armend Ahmeti dhe bashkëpuntores profesionale Adelina Idrizi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.N. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me numër personal ..., të cilin e përfaqëson në bazë të autorizimit Baton Bukoshi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "S.", me seli në Prishtinë, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga Y.M., me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit 23,878.56 €, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 04.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit S.N. nga fshati ..., Komuna Ferizaj ashtu që: DETYROHET e paditura K.S "S." me seli në Prishtinë, që sipas përgjegjësisë të ndarë prej 80% të fajësisë së KS "S." dhe 20% të paditësit t'ia kompensoj dëmin lidhur me aksidentin e komunikacionit të datës 27.11.2021, rreth orës 16:24 min, lokacioni fshati B., Komuna Ferizaj dhe atë:

-Në emër të dëmit jo material (satisfaksion):

-Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej.....3,000 €
-Për frikën e përjetuar, shumën prej.....2,000€
-Për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 10%, shumën prej.....3,000 €
-Për shëmtim.....600,00€

-Në emër të dëmit material:

-Për ndihmën e personit të tretë dhe kujdesin e huaj, për 6 javë, për shumën prej.....336,00 €
-Për ushqim të përforcuar, për 8 javë, shumën prej.....448,00 €
-Për shpenzimet e shërimit për rehabilitim fiziatriko-psikik, për 24 ditë, shumën prej576,00 €
-Për shpenzimet e shërimit (sipas faturave), shumën prej..... 1,610.04€

Gjithsej shuma për kompensim: 11,570.04€
(njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë euro e katër cent)

II. DETYROHET e paditura K.S "S." me seli në Prishtinë, që paditësit S.N., shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë së bashku me normën e kamatës në

lartësi prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt. 04.03.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.24.01.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit S.N. përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbjet trupore – fizike në shumën prej 4,000 €; për frikën e përjetuar në shumën prej 3,000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 2,000 €, për shëmtim shumën prej 1.400€, për ndihmë nga personi i tretë shuma prej 294.00 €, për ushqim të përforcuar shuma prej 392.00€, për shpenzimet e shërimit për rehabilitim fiziatriko-psikik, shumën prej 144€, për shpenzimet e shërimit (sipas faturave), shumën prej 1,078.52€.

IV. DETYROHET e paditura K.S “S.” me seli në Prishtinë, që paditësit, S.N. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore sipas suksesit të treguar në këtë procedurë t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,148.00 € (një mijë e njëqind e katërdhjetë e tetë euro), dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm ndërsa kërkesa lidhur me precizimin e kërkesëpadisë në shumën prej 208,00€ refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit S.N., N.N., U.N., dhe B.N., përmes përfaqësuesit të autorizuar, Baton Bukoshi, avokat me seli në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me dt.24.01.2022, kanë parashtruar padi kundër të paditurës K.S "S.", me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material dhe jo material. Në padi ndër tjera pretendohet se me dt.27.11.2021, rreth orës 18:24 ka ndodhur një aksident trafiku si pasojë e fajit të vozitësit H.Z., i cili ishte duke e drejtuar veturën e tipit Audi A8 me targa regjistrimi ... në rrugën B.-Ferizaj dhe nga mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes nga pakujdesia godet me pjesën e parë nga ana e majtë paditësin S.N. në cilësi të këmbësorit i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë me ç’rast i shkakton lëndime trupore të rënda, dhe ishte dërguar në QKUK në Prishtinë, i njëjti nga ky aksident ka pësuar dhimbje të rënda fizike, frikë primare dhe sekondare, zvogëlim të aftësisë jetësore të shkallës së lartë dhe shëmtim të shkallës së lartë, e po ashtu paditësit e tjerë kanë pësuar vuajtje shpirtërore për shkak të invaliditetit të rëndë të anëtarit të familjes. Në seancën përgaditore, dhe atë të shqyrtimit kryesor, dhe në fjalë përfundimtare paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka theksuar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se meqenëse kontestuese mbetet vetëm lartësia e kërkesëpadisë, propozon nxjerrjen e ekspertizës mjekësore me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë dhe ekspert të psikiatrisë në mënyrë që të njëjtit të japin mendimin e tyre lidhur me llojin dhe intensitetin e lëndimeve të pësuar. Po ashtu ka hequr dorë

nga padia lidhur me paditësit N.N., U.N. dhe B.N., duke mbetur në vendin e paditësit vetëm S.N.. Përmes precizimit të lartësisë së kërkesëpadisë, ka kërkuar që të aprovet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shumat si në vijim: për dëmin material: në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 7,000 Euro; për frikë shumë prej 5,000 Euro; për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 5,000 Euro; në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtim të shkallës së mesme 2.000 Euro për dëmin jo material: në emër të ndihmës së personit të tretë shumë prej 630.00 Euro; në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 840.00 Euro, në emër të shpenzimeve të shërimit për rehabilitim shumë prej 720.00 Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të shërimit (sipas faturave) shumë prej 2.688.56.00 Euro, në shumë të përgjithshme prej 23,878.56 Euro, të gjitha këto me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke e llogaritur nga data e ushtrimit të padisë, e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, dhe në fjalë përfundimtare përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se në këtë çështje juridike e konteston padinë për nga baza dhe lartësia e saj, pasi që paditësi nuk e kishte të kompletuar dokumentacionin duke shtuar se kjo procedurë është përfunduar si procedurë administrative, e që po ashtu kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë pas shiqimit të ekspertizës së komunikacionit pasi që paditësi ka kaluar rrugën në magjistrale dhe ka lëshime edhe nga ana e tij, e kundërshton lartësinë e kërkesëpadisë sepse çmimet në të janë tejet të larta dhe e tejkalojnë qëllimin e kompensimit.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.19.01.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse ka administruar provat vijuese: Ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga inxhinieri B.L. nga Fushë Kosova e dt 14.12.2023, Ekspertiza mjekësore e ekspertëve dr. V.B. dhe Dr. V.B.R. e dt 13.11.2023, Fletëlëshim i dt 26.03.2022, i B. së K. shpk, Vërtetim i dr. Y.M. i dt 08.06.2022, Raport fizioterapeutik i lëshuar nga fizioterapia plus i dt11.02.2022, Faturë e dt 13.12.2021 në shumë prej 610 euro, Faturë e dt 07.03.2022 me nr ... në shumë prej 676 euro, për S.N., Faturë e dt 07.03.2022 me nr ... në shumë prej 676 euro, për N.N., Raport specialistik i dt 27.01.2022, i dr N.D., Raport specialistik i dt 24.02.2022, i dr Xh.G., Raporti specialistik i poliklinikës së GJENEZIS i dt 06.04.2022, Faturë në shumë prej 10 euro me nr ..., Njoftim për plotësim të dokumentacionit e të paditurës 21.02.2022, Faturën me nr ... në shumë prej 38.20 euro, me nr ... në shumë prej 6.05, me nr ... në shumë prej 1.9 euro, ... në shumë prej 4.70 euro, me nr ... ne shumë 8.8 euro, me nr ... në shumë prej 24 euro, me nr ... në shumë prej 9.3 euro, me nr ... në shumë prej 2 euro , me nr ... ne shumë 4.7 euro, me nr ... shumë 5.8 euro, me nr ... në shumë 19.9 euro, me nr ... në shumë 1.5 euro, me nr ... në shumë 8.5 euro, me nr ... në shumë 9.9 euro, me nr ... në shumë 20 euro , me nr ... në shumë 4.9, me nr ... në shumë 13.6 euro , me nr ... në shumë prej 4.5, me nr ... në shumë 6.8, me nr ... në shumë prej 31.5 euro, me nr ... në shumë prej 4 euro, me nr ... në shumë prej 3 euro, me nr ... në shumë prej 9.9 euro, me nr ... në shumen prej 4 euro, me nr ... në shumë prej 9.4euro, me nr ... në shumë prej 3.69, me nr ... në shumë prej 18.7,

me nr ... në shumën prej 3.3 euro, me nr ... në shumën 6.3 euro, me nr ... në shumën prej 23.43 euro, me nr ... në shumën prej 19.4, me nr ... në shumën prej 1.6 euro me nr ... në shumën prej 9.6 euro, me nr ... në shumën prej 8.2 euro, Kuponi fiskal nr ... në shumën prej 35 euro Faturë T... në shumën prej 2800 lekë, T... në shumën prej 2700, T.. në shumën prej 9000 lekë, T... shumën 3500 lekë.

Faktet

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se me dt.27.11.2021, rreth orës 18:24 në fshatin B. Komuna Ferizaj, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, i cili është shkaktuar kur ngasësi i automjetit të udhëtarëve "Audi A8" me targa ..., i drejtuar nga H.Z., ishte duke lëvizur nga Prishtina në drejtim të Ferizajt dhe me të arritur në fshatin B. duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës nga pakujdesia gjatë drejtimit të automjetit me pjesën e parë të anës së majtë të automjetit e godet këmbësorin S.N. tani paditësin, i cili ishte duke e kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë në drejtim të lëvizjes së automjetit dhe i shkakton lëndime të rënda trupore. Po ashtu, nuk rezulton të jetë kontestues fakti se automjeti me të cilin ishte shkaktuar aksidenti ka qenë i siguar tek e paditura. Me leximin e ekspertizës së komunikacionit, e nxjerrë në bazë të propozimit të të paditurës, është vërtetuar se deri te ky aksident i komunikacionit rrugor ka ardhur si shkak i lëshimeve primare të shoferit të automjetit A (Audi A8) me targa: ...me veprimet e tij: - vozitje e pakujdesshme, -moskujdes ndaj këmbësorit në rrugë dhe lëshime sekondare: në këtë aksident ka patur edhe këmbësori i lartëcekur, i cili në momentin e aksidentit në mënyrë të pasigurtë, duke mos verifikuar më parë prezencën e mjeteve në rrugë (drejtpërdrejt para mjetit në lëvizje dhe nën kushte të dukshmërisë së zvogëluar) kishte bërë kalimin e pasigurtë të rrugës në momentin kur në afërsi të tij në anën e djathtë ishte duke lëviz shoferi me automjetin A. Pra nga kjo rezulton se përgjegjësia primare në shkaktimin e këtij aksidenti është tek drejtuesi i automjetit i cili ka qenë i siguar te e paditura, ndërsa këtu paditësi ka përgjegjësi sekondare në shkaktimin e këtij aksidenti. Duke u bazuar në këtë gjendje faktike kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë dhe kjo përgjegjësi sipas vlerësimit të kësaj gjykate për paditurën si përgjegjëse primare është vlerësuar me 80%, ndërsa 20% këtu paditësit dhe mbi këtë bazë është vendosur. Sipas Nenit 176 (Përgjegjësia e ndarë), paragrafi 1 të LMD parashihet se: "1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar."

Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ka ngelur çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, me ç'rast pala e paditur pretendon se shumata e kërkuara nga ana e palës paditëse nuk i përgjigjen plotësisht vëllimit të dëmit të pësuar për paditësin nga aksidenti i komunikacionit.

Nga dokumentacioni mjekësor, respektivisht raporti mjekësor, i lëshuar nga QKUK me nr. prot,... me dt.28.11.2021- 22.12.2021, fletëlëshimi nga Klinika e Ortopedisë, si dhe fletëlëshimi nga B.e.K. me nr. ... ku ka qëndruar nga data 28.02.2022-26.03.2022 vërtetohet se paditësi si

pasojë e aksidentit kishte pësuar dg. Frakturë e hapur e gradës i bimmalleollarë e nyjës së zogut të këmbës së djathtë. Frakturë e procesit transvers të unazës L1 dhe frakturë e kokës së fibullës së djathtë , rtg e nyjës T/C të djathtë, për çka edhe i ishte nënshtruar një intervenimi kirurgjik në zogin e këmbës.

Nga fletëlëshimet e lëshuara nga Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim – B.e.K. në K., vërtetohet se paditësi i është nënshtruar treatmentit rehabilitues në këtë qendër dhe atë në periudhë: nga dt.28.02.2022 deri me datë 26.03.2022. Nga faturat e lëshuara nga Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim – B. e K. në K., me nr. ..., e dt.07.03.22, vërtetohet se për shërbimet e ofruara pranë kësaj qendre, detyrimi për pagesë për paditësin ka konsistuar në shumën e përgjithshme prej 676.00 Euro ndërsa gruaja e tij N.N. sipas faturës Nr. ..., e dt. 07.03.2022 shumën prej 676,00 Euro.

Nga raporti specialistik i datës 27.01.2022, është vërtetuar se paditësi pas tretmanit ka arritur rezultat si dhe shihet në rtg pozita shume e mire e materialit të furnizimit si dhe ngjitja kockore.

Sipas propozimit të palës paditëse, është bërë nxjerrja e provës përmes ekspertizës mjekësore, dhe atë me ekspertë nga lëmia e ortopedisë - traumatologjisë, respektivisht e psikiatrisë, me ç'rast për ekspertë janë caktuar Dr. V.B. - Ortoped - traumatolog dhe Dr. V.B.R. - Psikiatre. Ekspertët e lartëcekur kanë pasur për detyrë që në bazë të njohurive profesionale, pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit dhe vlerësimit të dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës të japin mendimin e tyre profesional lidhur me shkallën dhe intensitetin e lëndimeve të pësuar, dhimbjeve fizike, frikës, si dhe të konstatojnë nëse të paditësi si pasojë e aksidentit ka ardhur në shprehje zvogëlimi i aktivitetit jetësor, shëmtimi, nëse ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë të personit të tretë, e po ashtu vlerësimi i faktit nëse shpenzimet e shërimit i përshtaten natyrës së lëndimeve të pësuar. Ekspertët e lartëcekur kanë dhënë mendimin dhe konstatimin e tyre me shkrim me dt.13.11.2023, ndërsa nuk kanë prezentuar në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. 19.01.2024 pasi që palët nuk kishin vërejtje në ekspertizë si dhe nuk kërkonin sqarime shtesë. Në mendimin e dhënë, ekspertët fillimisht kanë konstatuar se pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, i njëjti si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt.27.11.2021, ka pësuar këto lëndime trupore: frakturë të hapur e gradës I bimmalleollarë e nyjës së zogut të këmbës së djathtë, frakturë e procesit transvers të unazës L1 dhe frakturë e kokës së fibullës së djathtë si dhe i njëjti i ishte nënshtruar një intervenimi kirurgjikal në nyjën e zogut të këmbës së majtë, lëndime këto të cilat kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Në raport me dhimbjet fizike, ekspertët përkatës kanë konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur 3 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të cilat kanë zgjatur 28 ditë, për shkak të dhimbjeve në regjionin e shpinës dhe nyjës së zogut të këmbës së majtë si dhe nyjës së gjurit të djathtë duke përfshirë edhe dhimbjet e pas intervenimit kirurgjikal; dhimbje fizike të intensitetit më të ulët, që posedon ende sforcime fizike, ecje të gjata ecje në shkallë si dhe ndikime klimatike. Në raport me frikën e përjetuar, është konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, e shfaqur në momentin e godjtes nga ana e automjetit zhvendosja fizike e tij deri tek rënia në tokë ku edhe ka përfunduar rreziku drejtpërdrejtë për jetën.; frike sekondare të intensitetit të lartë e cila ka

zgjatur 3 ditë, si gjendje stresi pas traumës, e shfaqur me reagime emocionale, ankth lëndimet e pësuar dhe moshën e tij. Me dhënien e ndihmës mjekësore dhe realizimin e ekzaminimeve të nevojshme diagnostifikuese, kjo frikë gradualisht është zbehur dhe ka kaluar në: frikë sekondare të intensitetit të mesëm - e cila ka zgjatur edhe për 8 javë, duke u përballur me pasojat shëndetësore të aksidentit, duke përfshirë trajtime spitalore, intervenimin kirurgjikal dhe periudhën post operative, toaleten dhe fashimin e vazhdueshëm të plagës, përjetime të herë pas here të dhimbjeve trupore të përcjella me pozitë të detyruar, pamundësinë për të realizuar aktivitete të përditëshme jetësore në mënyrë të pavarur, me shqetësim dhe brengosje për ecurinë dhe suksesin e trajtimit dhe shërimit bazuar në moshën e tij të shtyer. Tutje është konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të ulët, e cila vazhdon akoma herë pas here gjatë pjesëmarrjes në komunikacion e posaçërisht në situata të ngjashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndjejë shqetësim, ankth dhe pasiguri. Tutje në mendimin dhe konstatimin e dhënë, ekspertët përkatës kanë konstatuar se zvogëlimi i aktivitetit jetësor është i shprehur në shkallën prej 10%, për shkak zvogëlimit të lëvizjes së nyjës së zogut të këmbës të shkallës së mesme. Shëmtim trupor ka të shkallës së ulët si pasojë e vrazës së mbetur pas intervenimit kirurgjikal. Ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 6 javë, ndihmë e cila konsiston në përgaditjen dhe ofrimin e ushqimit si dhe mbajtjen e higjenes personale si dhe disa ndihmesa tjera ditore siç është veshmbathja etj. Tutje është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 8 javë, ushqim ky i pasur me proteina, albumina, minerale dhe vitamina. Rehabilitimi fiziko - terapeutik ka qenë i nevojshëm për 10 ditë brenda vitit të parë pas aksidentit. Për fund, është konstatuar se faturat të cilët gjenden në shkresat e lëndës, i përgjigjen mjekimit si pasojë e lëndimeve, përkatësisht kanë lidhje kauzale me lëndimet e pësuar në aksidentin e komunikacionit.

Baza juridike

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, referuar momentit kur është krijuar raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse, duhet referuar dispozitave të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrdhëniet e Detyrimeve. Dispozita nga neni 137 e këtij ligji përcakton definicionin e dëmit dhe është e formuluar në këtë mënyrë: "Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)". Në këtë mënyrë, nga interpretimi i dispozitës së lartëcekur rezulton se ekzistojnë dy kategori të dëmit: 1) dëmi material, i cili ndahet në dy nënkategori: 1) zvogëlim i pasurisë dhe 2) pengim i rritjes së saj dhe 2) dëmi jo material, i cili konsiston në shkaktim të dhimbjeve fizike, vuajtjeve psikike dhe frikës. Detyrimin për shpërblimin e dëmit material e definojnë dispozita e nenit 169 të këtij ligji, e cila parasheh që: "Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi. Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t'ia paguajë të dëmtuarit shumën

përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme". Në funksion të njejtë, dispozita e nenit 174 përcakton që: "Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim". Në anën tjetër, çështja e shpërblimit të dëmit jo material përcaktohet me dispozitën e nenit 183 të LMD-së, e cila parashihet që: "Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror."

Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës

Në rastin konkret, në bazë të të gjitha provave të administruara, e në kuptim të dispozitave të lartëcekura, rezulton se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të dt 27.11.2021, ka pësuar dëm jo material (i cili konsiston në dhimbje fizike, frikë dhe dhimbje shpirtërore si pasojë e zvogëlimit të aktivitetit jetësor), si dhe dëm material, (i cili konsiston në nevojën për ndihmën e personit të tretë, ushqim të përforcuar dhe shpenzime të shërimit). Kategoritë e lartëcekura të dëmit të pësuar, përfshirë edhe intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre janë të specifikuar në ekspertizën mjekësore, të punuar nga ekspertët Dr. V.B. - Ortoped - traumatolog dhe Dr. V.B.R. - Psikiatre. Të gjeturat e kësaj ekspertize janë elaboruar në detaje në pjesën e mësipërme të arsyetimit të këtij aktgjykimi dhe këto të gjetura nuk janë kontestuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse në seancën e shqyrtimit kryesor. Mbi këtë bazë, Gjykata ekspertizave në fjalë ia falë besimin e plotë, për faktin se janë përpiluar në mënyrë profesionale dhe mbi bazën e vlerësimit të parametrave të nevojshëm në drejtim të sqarimit të rrethanave vendimtare sa i përket vendosjes së kësaj çështje. Krahas vërtetimit të faktit se paditësi ka pësuar format e lartëcekura të dëmit, buron edhe detyrimi i të paditurës për shpërblimin e të njejtit. Bazuar në natyrën e dëmit të pësuar, rivendosja e gjendjes së mëparshme për paditësin është e pamundur, andaj shpërblimi i dëmit mund të realizohet përmes caktimit të detyrimit të të paditurit për pagesën e një shume të të hollave.

Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi që në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të përjetuara ta detyrojë të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 3,000 Euro, duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e këtyre dhimbjeve të konstatuara nga ekspertiza mjekësore, ku theksohet se paditësi si pasojë e aksidentit ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë të cilat kanë zgjatur 3 ditë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm të

cilat kanë zgjatur 28 ditë, si dhe dhimbje fizike të intensitetit më të ulët, për të cilat paditësi ende ankohehet.

Në emër të dëmit jo material për frikën e përjetuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 2,000 Euro, po ashtu duke marrë në referencë intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar nga aksidenti, të specifikuar në ekspertizën mjekësore, ku konstatohet se paditësi ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm - e cila ka zgjatur edhe për 8 javë, si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët, e cila vazhdon akoma herë pas here gjatë pjesëmarrjes në komunikacion e posaçërisht në situata të ngjashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndjejë shqetësim, ankth dhe pasiguri.

Sa i përket zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor, Gjykata e obligoi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 3,000 Euro, duke marrë për bazë edhe konstatimin nga ekspertiza mjekësore se paditësi si pasojë e aksidentit të komunikacionit ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 10%.

Lidhur me shumat e gjykuara në emër të dëmit jo material, Gjykata iu referua edhe Udhëzuesit të Gjykatës Supreme të Kosovës, 41/2023, të dt.27.02.2023, me të cilin janë përcaktuar disa kritere orientuese lidhur me lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material, e po ashtu duke pasur parasysh se paditësi sipas ekspertizës së komunikacionit kishte lëshime të natyrës sekondare duke u kualifikuar si 20% përgjegjës në këtë aksident, andaj shumat e gjykuara si në pikën I. të dispozitivit të këtij Aktgjykimi janë vlerësuar sipas kësaj llogaritje.

Në raport me dëmin material, Gjykata e detyroi të paditurën që në emër të ndihmës së personit të tretë, t'ia paguajë paditësit shumën prej 336,00 Euro, duke marrë për bazë se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar se kohëzgjatja e nevojshme e kësaj ndihme përkon në periudhën ditore prej 6 javësh, konform nenit 323 të LPK.

Sa i përket nevojës për ushqim të përforcuar, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 448.00 Euro, marrë parasysh faktin se nga ekspertiza mjekësore është konstatuar që paditësi si pasojë e dëmit të pësuar nga aksidenti ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 8 javë, konform nenit 323 të LPK. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se për këto dy kategori të dëmit material (ndihma e personit të tretë dhe nevoja për ushqim të përforcuar), ndonëse ka qenë e mundur që të argumentohet që kanë ardhur në shprehje me rastin e shkakimit të dëmit, në praktikë është dukshëm e vështirë për tu argumentuar nga ana e paditësit lartësia e saktë e shpenzimeve të krijuara përmes prezantimit të provave materiale. Në këtë kuptim, është përcaktuar një standard që duhet vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të Gjykatës, me rastin e vendosjes së një shpërblimi adekuat për këto lloje të dëmit.

Lidhur me shpenzimet e shërimit për rehabilitim fiziatriko-psikik, Gjykata e detyroi të paditurën që t'ia paguajë paditësit shumën prej 576,00 Euro për 24 ditë, konform ekspertizës mjekësore përkatësisht faqes 2 të saj, në të cilën është përcaktuar se rehabilitimi fiziko-terapeutik ka qenë i

nevojshëm në vitin e parë pas aksidentit 14 ditë dhe 10 ditë në vitin e dytë pas aksidentit, ky shërim gjen mbështetje në faturat në dosje.

Sa i përket shpenzimeve të shërimit, shpenzimet në faturat e paraqitura i përgjigjen mjekimit si pasojë e lëndimeve, konform ekspertizës mjekësore përkatësisht faqes 3 të saj. Por gjykata nga shuma totale prej 2688,56€ e kërkuar nga paditësi zbriti shumën prej 676,00€ sipas faturës Nr. ..., e dt. 07.03.2022, në emër të gruas së paditësit zonja N.N. me arsyetimin se në qendrën për mjekësi fizikale dhe rehabilitim janë të punësuar staf përkatës dhe profesional të cilët ushtrojnë kujdesin mbi pacientët e qendrës ndërsa shpenzimet e familjarëve të personave nuk mund të kompensohen për këtë formë të dëmit sepse nuk janë të domosdoshme. Nga shuma e zbritur prej 2012,56€ gjykata zbriti -20 % të përgjegjësisë së paditësit, që i bie 1610,04€ . Andaj rezultoi shuma për kompensim në total prej 1610,04€. Kujdesi i familjarëve të personit të dëmtuar ndaj personit të dëmtuar hyn në llojin e dëmit material përkatësisht ndihma dhe kujdesi i huaj, i cili përbën kategori tjetër të dëmit. Mbi këtë bazë, Gjykata në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke gjykuar shumat e specifikuara në këtë pikë të dispozitivit, me bindjen se në raport me dëmin material të pësuar, shumat e tilla janë të nevojshme për ta kthyer gjendjen materiale të të dëmtuarit - këtu paditësit në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë para se të shkaktohej dëmi. Sa i përket dëmit jo material, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paraqesin një lloj satisfakcioni moral në raport me cenimin që i është bërë paditësit, ndërsa me rastin e vendosjes lidhur me këtë kërkesë është marrë në konsideratë rëndësia e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim se kompensimi i gjykuar nuk guxon të paraqet qëllime lukrative (fitimprurëse). Njëherit me rastin e caktimit të shumave të gjykuara Gjykata ka marrë për bazë karakteristikat personale të paditësit si dhe këto shuma i ka bazuar në praktikën e gjykatave në Kosovë, lidhur me caktimin e lartësisë për dëmin jo material dhe material.

Arsyet mbi refuzimin e padisë

Gjykata në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: për dhimbjet trupore – fizike në shumën prej 4,000 €; për frikën e përjetuar në shumën prej 3,000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumën prej 2,000 €, për shëmtim shumën prej 1.400€, për ndihmë nga personi i tretë shuma prej 294.00 €, për ushqim të përforcuar shuma prej 392.00€, për shpenzimet e shërimit për rehabilitim fiziatriko-psikik, shumën prej 144€, për shpenzimet e shërimit (sipas faturave), shumën prej 1,078.52€. Kjo për faktin se çfarëdo shume e gjykuar përtej asaj që i është njohur paditësit në emër të kompensimit të këtyre formave të dëmit, nuk do të ishte në proporcion të plotë me intensitetin apo vëllimin e dëmit të pësuar dhe do ta tejkalonte qëllimin të cilit i shërben një shpërblim i tillë. Gjykata sjellë në vëmendje faktin se qëllimi i realizimit të kërkesës për kompensim nuk ka të bëjë me pasurimin e palës e cila e ka parashtruar kërkesën, por me kthimin e një gjendje e cila ka qenë para shkakimit të dëmit, respektivisht ofrimin e një satisfakcioni moral për palën e dëmtuar në raport me të mirat që i janë cenuar.

Vendimi lidhur me kërkesat aksesore

Gjykata në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material do të llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, dt.04.03.2024, e deri në pagesën definitive, ndërsa për shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit material, do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë, dt.24.01.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parasheh që: "Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë". Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore nga e cila fillon të rrjedhë kamata për të dy format e dëmit (jo material dhe material) iu referua Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020, të dt.02.12.2020, konkretisht pjesës së tretë, pikave XIV dhe XV të këtij Mendimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, nga pika IV. e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitat nga nenet 452, 453, lidhur me nenin 463.1 të LPK, duke e obliguar të paditurën që paditësit, t'ia kompensojë shumën e shpenzimeve të nevojshme dhe të domosdoshme të krijuara deri në këtë fazë të procedurës sipas kërkesës së specifikuar në vlerë të përgjithshme prej 1,148.00 Euro dhe atë: shumën prej 208.00 Euro në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 100.00 Euro në emër të taksës gjyqësore për padi, shumën prej 300.00 Euro në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizve mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë, si dhe shumën prej 540.80 Euro për përfaqësim në dy seanca gjyqësore të mbajtura (270.40x2=540.80). Sa i përket shumës së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrave tarifor 6 dhe 7) si dhe Udhëzimit Administrativ të KGJK lidhur me Unifikimin e Taksave Gjyqësore i dt. 22.03.2017. Ndërsa kërkesa lidhur me precizimin e kërkesëpadisë në shumën prej 208,00€ refuzohet si e pabazuar sepse kjo parashtresë nuk hyn në grupin e parashtresave për të cilat paguhet kompensimi.

Bazuar në të lartëcekurat, në mbështetje të dispozitës së nenit 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 04.03.2024

G j y q t a r i,
Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqura kanë të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.